



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agencija Nabavke-Central Procurement Agency

KONTRATË PËR FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS:

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira

LOT II

NUMRI I PROKURIMIT: AQP 17 006/2-111

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I: KONTRATA

Agjencia Qendrore e Prokurimit , (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
dhe

ART HOUSE shpk nr. fiskal" 600231774 adresa Sheshi Bill Klinton Bll 9/9 (në vazhdim "Furnizuesi"),
në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira, me numër identifikues: AQP 17-008-111

Numri rendor i kontratës: 002/2018 DPQ Lot II

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: dërgesa, instalimi, mirëmbajtja, shërbimet printimit, fotokopjimit dhe skanimit, tonerit dhe softuerin identifikimin siç kërkohet në specifikim teknik nga Furnizuesi.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim/shërbim do të jetë nga momenti i nënshkrimit të kontratës por jo më vonë se 60 ditë nga koha e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon pas 74 muajve. Kontraktuesi mundet të fillojë me implementim të kontratës kur do që është i gatshëm (pjesërisht) por jo më vonë se 60 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Te Autoritetet Kontraktuese / njësitë kërkuese të cekura në UA dhe aneksin 7.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë **Incoterm 2010**

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontratë" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 1,827,000 €; Njemiljon e tetëqind e njëzetë shtatë mijë euro e zero cent. **Sasia është sasi e përafërt e parashikuar gjatë 6 vjet apo 72 muajve sa do të jetë kohëzgjatja e kontratës AK.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqipe** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27.02.2018
Vula:	

[Ne rast te kontratave me vlere te madhe]

Emri:	Ekrem Rexha
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	27.02.2018
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	BLIN ZEQIRI
Pozita:	DREJTOR MENAXHUES
Nënshkrimi:	
Data:	01.03.2018
Vula:	

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkomporuar me referencë në të.

1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk nje lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se përkohshme të pranimit.

Neni 10 Sigurimi

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruar plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 11 Programi i realizimit

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë së paku këto:

i) rendin sipas të cilit Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe

ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsyë autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të njoftoj vendimin e tij të aprovimit i përmendur në Nenin 11.2 brenda afateve të përmendura në kontratë programi i tillë i realizimit duhet të konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Në qoftë se nuk ka afat të caktuar, ato do të konsiderohet të aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim të ai.

11.5 Para pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të jenë në detaje të tilla që do të mundësojë Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualet dhe vizatimet do të jenë në gjuhën e kontratës dhe në formë dhe numrat të tilla të deklaruar në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të përkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tilla janë furnizuar Autoritetit Kontraktues

Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifave doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimtë sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrave

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë të drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mbledhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të

Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimi në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimi.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimi në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimi;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimi të urdhrat për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtësore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelle të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizim vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohej se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Furnizues sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

20.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhesh brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimin derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimin të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtrinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj. Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhet ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

22.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

23.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

23.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

23.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 24 Obligimet për garanci

24.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

24.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata

finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbytje brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Siguria ekzekutimit	9.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% të vlerës së kontratës për kohëzgjatjen prej 75 muajsh.
Sigurimi	10.1	N/A
Programi ekzekutimit	11	N/A
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	N/A
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>AK që janë shfrytëzuese të kësaj kontrate bëjnë pranimin e çekur sipas specifikimit teknik</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	N/A
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	N/A
Pagesa	20.1	Pagesat do të bëhen 15 ditë pas përfundimit të muajit paraprak Pagesa do të bëhet nga ana e secilit Autoritetit Kontraktues i identifikuar në Aneksin 7 për materialin zyrtar vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga

		cilido autoritetet kontraktues/Njësi Kërkuese i specifikuar ne Aneksin 7. Kërkesat për pagese do të bëhet vetëm për Shfrytëzimi i fotokopjeve me qira në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit te faturave. Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Furnizuesi duhet të dorëzoj tek secili AK i specifikuar e Aneksin 7 një faturë origjinale dhe një kopje për fotokopje/printer të cilat janë shpërndarë dhe /ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro. Çdo faturë duhet të përmbajë të paktën informacionin e nevojshëm.
Dorëzimi	21.3	Dërgesa/shërbimet: Dorëzimi/shërbimet do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	24.1	N/A

	24.5	N/A
Shërbimet pas shërbimit	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues - AQP-se, të zyrtarëve përgjegjës të Autoriteteve Kontraktuese që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të Furnizuesit me mallra ose shërbime.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Pjesë përbërëse e policës: 010223

Për: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: ART HOUSE SHPK, SHESHI BILL KLINTON BLL 9/9
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE: UA-2016-17-5236-1-1-1/FA060

Titulli i aktivitetit të prokurimit: SHFRYTEZIMI I FOTOKOPJEVE I PRINTEREVE ME QIRA - PJESA 2
Numri i prokurimit: UA-2016-17-5236-1-1-1

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **182700 EURO (NJEQIND E TETEDHJETE E DY MIJE E SHTATEQIND EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **182700 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen prej **2018-03-01** deri **2024-06-02**

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2018-03-01 11:42:35



PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

PJESA I. FORMULARI I TENDERIT

Për: Agjencia Qendrore e Prokurimit , Nderresa e Germise Kati IV zyra A402
(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i kontratës: Shfrytzimi i fotokopjeve dhe printerve me qira

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: **AQP 17-008-111**. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

3. Çmimi total i tenderit është:

LOT 1: Vlera totale me shifra 3,402,000 € dhe

Vlera totale me fjale **tre milion e katerqind e dy mije Euro e zero Euro cent**

LOT 2: Vlera totale me shifra 1,827,000 € dhe

Vlera totale me fjale **nje milion e teteqind e njezet e shtate mije Euro e zero Euro Cent**

4. Ky tender është valid për një periudhë prej **120 ditëve** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës 10% të vlerës së kontratës.

6. Operatori Ekonomik kanë këtë nacionalitet: **Kosovar**

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender ne LOT 1 dhe LOT 2 me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër

[Në rast të konsorciumit]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] **si partner në konsorcium** të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

1. *[Signature]*
2. *[Signature]*
DE: 18 APR 2017
[Signature]

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË ⁶	ART HOUSE SHPK
ADRESA E PLOTE	BUL. BILL KLINTON, BL. 9/A, PRISHTINE
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	BLIN ZEQIRI
POZITA	DREJTOR MENAXHUES
NËNSHKRIMI	DREJTOR MENAXHUES
DATA	26/12/2017
VULA	

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1*		
Etj ... *		

* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin]

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]

Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën]

Vula e Udhëheqësit: _____

1. Lili

2. Gledy

⁶ Në rast të Grupit të OE emri i liderit të Grupit të OE

PJESA II. LISTA E ÇMIMEVE LOT 1

Nr.	Pershkrimi: Sherbimi Pay per Print per AK ne aneksin 7 te DT. " Shfrytzimi i fotokopjeve dhe printerve me qira"	Njësia matëse faqe e printuar/kopjuar	Sasia e perafert	Çmimi për njësi me tvsh €	Totali me tvsh €
1	Print/Copy A4	1 faqe	540,000,000	0.0063 €	3,402,000 €
Totali me gjithë TVSH					3,402,000 €

PJESA II. LISTA E ÇMIMEVE LOT 2

Nr.	Pershkrimi: Sherbimi Pay per Print per AK ne aneksin 7 te DT. " Shfrytzimi i fotokopjeve dhe printerve me qira"	Njësia matëse faqe e printuar/kopjuar	Sasia e perafert	Çmimi për njësi me tvsh €	Totali me tvsh €
1	Print/Copy A4	1 faqe	290,000,000	0.0063 €	1,827,000 €
Totali me gjithë TVSH					1,827,000 €

Verejtje/Sqarim:

Ju duhet të plotësoni dhe të dorëzoni çmimet në vijim **vetëm pasi keni lexuar, kuptuar, pranoni dhe mund të përmbushni të gjitha kërkesat e dhëna në Aneks 1 Kushtet e Referimit dhe Specifikacionet teknike të detyrueshme**. Në çmimet njësi të poshtë shënuar duhet të përfshini të gjitha shpenzimet si transportin i pajisjeve dhe stafit tuaj, shpenzimet tjera transite/anësore dhe të gjitha pjesëve rezervë përfshirë tonerëve/cartridge, softuer... etj, si dhe koston për skanim. Në Çmim do të llogaritet edhe sherbimet e fotokopjimit kolor ku per nje faqe kolor gjatë kalulimit do te llogaritet si dy faqe bardhezi per printim A4. Ndersa printimin e A3 aparatet e llogarisin si dy faqe A4.

AK shfrytzuse të kesaj kontrate posedoj fotokopje te cilat kanë mundësi te integrohen ne sisem me kartela te rrjetit dhe kontraktuesit do ti marrin ne shfrytzim ato dhe mungesen do ta kompensojn me sjelljen e aparateve te veta. Aparatet qe janë dispozicion të AK do te mirmbahen nga kontraktuesi me te gjitha shpenzimet e llagaritne ne çmimin e ofertuar per faqe si ne rastin e aparatit te kontraktuesit pa ndonje ndryshim te çmimit te ofertuar. Aparatet qe posedohen nga AK ne aneksin 7 janë rreth 30 % të sasis se nevojshme per kryejn e ketyre sherbimeve por kjo varion nga institucioni ne institucion dhe mbetet qe kontraktuesit te shtojn aparatet sipas nevojave te AK pavarsisht se sa është numri i tyre. Ne perfundim të kontrates kontraktuesit do te dorzojn ne gjendje te rregullt te punës këto aparate te AK. Keto aparate do të dorzohen/pranohen nga nje komision i AK dhe Kontraktuesit me process verbal me shkrim. Sasia indikative është perafersisht e saktë sido qoft kontraktori do të kryej sherbime deri ne perfundimin e kontrates ne kohëzgjatje te lartcekur dhe ato sherbime faturohen ne pajtim me permbajtjen e kesaj DT. Sasia është sasi e përafërt e parashikuar gjatë 5.5 vjet apo 66 muajë muajve sa do të jetë kohëzgjatja e kontratës AK.

Çmimi per fotokopjim/printim te letres/faques lejohet te shenohet me **maksimum tre (3) numra pas preses dhjetore**. Çdo numer i shenuar pas numrit te tretë (3) nuk do te merret per baze ne llogaritje te vleres se ofertes.


1. Ely
2. G. G. G.
3.

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	ART HOUSE
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE OE:	BLIN ZEQRIRI
NENSHKRIMI:	
DATA:	26.12.2017
VULA:	



A. Lili

E. Duka





Per:

Agjencia Qendrore e Prokurimit
Ndërtesa e Gërmisë, kati IV A401
10000
Adresa e AK: Rr. Nëna Terezë,
Qyteti: Prishtinë

Nga:

Art House Sh.p.k.
Dardania blloku 9/a,
10000 Prishtinë, Kosovë
info@arthousepr.com
Tel+381 38 549 549

Date: 26 Dhjetor 2017

Deklarate per Specifikacione Teknike

Ne Art House Shpk Prishtine me adrese: Bul. Bill Klinton, Dardania Blloku 9/A
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës ju garantojme qe mallrat e ofruara
përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit

Singerisht i juaji,

Blin Zeqiri
Menaxher i Shitjes
Art House shpk.



Aneksi 1

Specifikimet Teknike Te Detyrueshme

Art House garanton se permbush specifikimin teknik të detyrueshëm si më poshtë për secilën prej kategorive të kërkuara.

Ju lutem shihni si ne vijim modelet te cilat permbushin specifikimet teknike te printereve dhe fotokopjeve:

1. Printer bardhe e zi prej 1-10 perdorues –Xerox Phaser 3610
(gjate vitit 2018 pajisja ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox VersaLink B400)
2. Printer me ngjyra prej 1-15 perdorues –Xerox Phaser 6700DN
(gjate vitit 2018 ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox VersaLink C400)
3. Printer Multifunksional bradh e zi prej 1-30 perdorues – Xerox WorkCentre 3655
(gjate vitit 2018 ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox VersaLink B405)
4. Printer Multifunksional me ngjyre prej 1-15 perdorues – Xerox WorkCentre 6655
(gjate vitit 2018 ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox VersaLink C405))
5. Fotokopje bardhe e zi prej 1-50 perdorues – Xerox WorkCentre 5330
(gjate vitit 2018 ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox VersaLink B7030)
6. Fotokopje bardhe e zi prej 50-100 perdorues – Xerox WorkCentre 5955
(gjate vitit 2018 ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox AltaLink B8055)
7. Fotokopje me ngjyra prej 10-100 perdorues – Xerox WorkCentre 7220
(gjate vitit 2018 ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox VersaLink C7020)
8. Fotokopje me ngjyra prej 100-200 perdorues – Xerox WorkCentre 7855
(gjate vitit 2018 ky model mund te zevendesohet me modelin me te ri Xerox AltaLink C8055)

Art House do te ofrojë pajisje me shpejtësi të printimit mbi 60 faqe për minutë vetëm nëse kërkohet specifikisht nga AK dhe në marrëveshje të plotë me AK.

Pajisja e ofruar me shpejtësi te printimit mbi 60 faqe ne minute eshte Xerox AltaLink B8065.

Specifikimet teknike te Softuerit menaxhues dhe kontrollues për Printim, Fotokopjim dhe Skanim

Solucioni softuerik i ofruar nga Art House Shpk – OptimiDoc do te kontrolloje qasjen në printera, fotokopje, skanera dhe ne pajisje multifunksionale, dhe do te menaxhoje alokimin e kostove me qellim te raportimit si dhe për qëllime te buxhetimit.

Softueri menaxhues do te mundësojë një ambient te sigurte te printimit dhe te dokumentimit ne mënyrë qe t'iu ndihmoje institucioneve që ta kontrollojnë shfrytëzimin e pajisjeve si dhe shpenzimet e printimit, fotokopjimit dhe skanimit.

** Per karakteristikat dhe detajet e softuerit Optimidoc ne e kemi ofruar edhe katalogun, te cilen mund ta gjeni ne oferten e dorezuar nga ne , se bashku me kataloget e pajisjeve.*


Parametrat e sigurisë

- Te gjitha pajisjet do te jene te shfrytëzueshme vetëm nëpërmjet qasjes me karte ne pajisje për të gjitha funksionet e printimit, fotokopjimit dhe skanimit.
- Te gjitha pajisjet do te pajisen me lexues kartash qe do të mundësojnë leximin e kartave për autorizim
- Aktualisht institucionet përdorin karta për hapjen e dyerve te ndërtesave dhe kartat mund te jene te llojit te ndryshëm andaj Art House do te ofrojë lexues te kartelave qe janë kompatibil me te gjitha kartat ekzistuese qe janë ne shfrytëzim nga personeli.
- Vetëm pas autorizimit me karte ne pajisje, shfrytëzuesit mund te shohin dhe kontrollojnë dokumentet dhe aktivitetet tjera ne lexuesit e kartelave dhe mund te marrin dokumentin e printuar, fotokopjuar si dhe mund te përdorin funksionin e skanimit
- Shfrytëzuesit mund te japin urdhrë për printim për dokumentet e tyre te ndryshëm dhe këto urdhra te printimit do te qëndrojnë ne server deri sa shfrytëzuesit të autorizohen me karte ne pajisje.
 - Shfrytëzuesit duhet te autorizohen në pajisje për të fotokopjuar apo skanuar në mënyrë që çdo aktivitet te regjistrohet në llogarinë e personit adekuat në server ku është i instaluar softueri menaxhues për printim ku pastaj se bashku me aktivitetet e printimit do të mund te gjenerohet raporti për te gjitha aktivitetet e kryera nga ai/ajo person adekuat si dhe mund te gjenerohet raport për te gjitha aktivitetet e një apo me shume pajisjeve te caktuara.
- Autorizimi me karte në pajisje do te mundësoje auditimin dhe kontrollin e personit qe i kryen funksionet e printimit, kopjimit dhe skanimit ne pajisje si dhe ne cilën pajisje po kryhen këto funksione nga ai/ajo.
- Lexuesit e kartelave do te jene kompatibil për pajisjet ekzistuese te cilat gjinden ne lokacionet e AK te cilat pajisje e kane si mundësi menaxhimin dhe kontrollimin e tyre nga serveri dhe (pajisjet ekzistuese te cilat e kane mundësinë e instalimit te lexuesit te kartelave dhe monitorimit nga serveri kryesore) si dhe për pajisjet e reja te ofruara nga OE.

Integrimi i softuerit menaxhues të printimit në serverët dhe ne infrastrukturën ekzistuese

- Ne institucionet e Republikës se Kosovës gjinden pothuajse te gjitha markat e pajisjeve si: HP, Canon, Dell, Konica Minolta, Ricoh, Xerox, Samsung, Lexmark, Kyocera, etj. dhe shume lloje/modele te ndryshme te pajisjeve te këtyre markave-prandaj solucioni qe eshte propozohet nga Art House eshte kompatibil me te gjitha llojet/modelet e pajisjeve për printim, skanim, fotokopjim ne mënyre qe te jete një solucion i vetëm softuerik i centralizuar për menaxhimin e printimit, fotokopjimit dhe skanimit ne Qendrën Shtetërore të të Dhënave (QSHDH), prej ku dhe do te kontrollohen dhe monitorohen te gjitha pajisjet dhe shfrytëzuesit e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës sa i përket aktiviteteve për printim, fotokopjim dhe skanim.

- Softueri menaxhues i printimit përkrahë platformën Microsoft Windows sepse Qeveria e Republikës së Kosovës përdorë platformën Microsoft në pothuajse të gjithë kompjuterët dhe serverët në të gjitha institucionet.
- Softueri menaxhues do të integrohet me Active Directory ekzistues në institucionet e AK.
- Softueri menaxhues do të suportoje databazat Oracle dhe SQL.
- Softueri do të ketë mundësinë e integritit me terminal serverët apo aplikacionet të cilat disa prej institucioneve mund të i kenë për përdorim të brendshëm.
- Softueri do të ketë kapacitet të monitorojë, kontrollojë dhe menaxhojë minimum 38,000 shfrytëzues (pra 38,000 është numri i punonjësve të institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës që do të përfshihen në këtë projekt).
- Softueri do të instalohet në Qendren Shtetërore të Dhenave të Republikës së Kosovës apo në institucionet që kanë infrastrukturë të ndarë nga QSHDH-ja, ku për këtë qëllim do të krijohen një ose disa server virtual me resurse të mjaftueshme që do të nevojitet softuerit për funksionim.
- Softueri do të ketë mundësinë e menaxhimit të serverëve të ndryshëm në bazë të serverëve që institucionet e Republikës së Kosovës momentalisht i kanë në dispozicion.
- Art House do të trajtojë ekipin e AK për administrim të softuerit i cili do të jetë i instaluar në infrastrukturën e AK, si dhe duhet të ofroj udhëzues/manuale për përdorim.
- Art House nuk mund të ketë qasje në server apo softuer nga jashtë në asnjë mënyrë të vetme dhe çdo aktivitet që do të kryhet, duhet të kryhet brenda lokacionet që do të jetë i caktuar për administrim dhe menaxhim të softuerit menaxhues.
- Të gjitha aktivitetet e pajisjeve dhe shfrytëzuesve do të menaxhohen, kontrollohen dhe monitorohen nga QSHDH apo Institucioni ku do të jetë i instaluar softueri menaxhues për printim. Instalimi i moduleve shtesë mund të lejohet vetëm në rastet kur Institucionet e caktuara mund të ketë shumë lokacione (PSH Ministria e punëve të Brendshme) atëherë nëse Art House dhe softueri i ofruar ofrojnë mundësinë e instalimit të ndonjë modulit shtesë të softuerit baze në këtë ministri i cili është pjesë e softuerit baze dhe i cili modul do të mund të ndihmojë softuerit që aktivitetet të kryhen më shpejtë në këtë institucion dhe/ose Ministri të caktuar! Art House si më poshtë i ka të specifikuar arkitekturën e softuerit për menaxhimin e të gjitha institucioneve dhe ceket se mënyra e arkitekturës (e centralizuar në një modul të vetëm apo e decentralizuar në disa module dytësore të cilat komunikojnë me softuerin baze i cili do të instalohet në QSHDH apo Institucionin që ka infrastrukturë të ndarë).
- Pas instalimit dhe konfigurimit të softuerit, Art House do të dokumentojë tek personat përgjegjës të AK të gjithë procesin e instalimit dhe konfigurimit të softuerit si dhe arkitekturën e instaluar të softuerit dhe menaxhimit të pajisjeve në formë të shkruar tekstuale dhe në formë grafike me diagrame të ndryshme të arkitekturës së punës së softuerit për institucionet e përfshira në projektin në fjalë, gjithashtu këto do të cekën edhe në PMN.
- Softueri do të ofrojë instalimin e shpejtë të drapjerit të pajisjeve me metodën "one step installation" në mënyrë që gjatë integritit të mos afektohen përdoruesit dhe/apo institucionet.
- Softueri do të ofrojë mundësinë e krijimit të llogarive të personave përgjegjës për secilin institucion. Personat përgjegjës për menaxhimin e pajisjeve, përdoruesve, kartelave, raporteve etj., duhen të kenë qasje vetëm për institucionin të cilin e menaxhojnë dhe të i kenë të ndara përgjegjësitë sipas kërkesave të AK.
- Art House do të ofrojë solucion në bazë të 3 opsioneve të paraqitura në grafiken dhe sipas specifikacioneve të paraqitura më poshtë:



Qendra Shtetërore e të Dhënave (QSHDH):

- Përfshinë minimum dy serverë. Te dy serverët do te përdoren për redundance.
- Te dy serverët (master dhe slave) do te lidhen ne SQL serverë të ndryshëm për të siguruar redundancën.
- Konekcioni në domain controller bëhet online tek server slave ndërsa te dhënat për përdoruesit janë te kopjuara (replikuara) ne mes te Slave serverit dhe Master serverit.

1. Institucioni – Infrastruktura A: Institucionet me shume printime (mbi 600,000 printime ne muaj).

Dy servere do te instalohen lokalisht. Të gjithë urdhrat për printim do te ruhen lokalisht. Serverët lokal te instaluar në institucion i dërgojnë vetëm të dhënat statistikore tek Serveri Slave në Qendrën Shtetërore të të Dhënave (QSHDH), ndërsa të gjitha aktivitetet tjera janë te menaxhuara lokalisht përmes serverëve ne institucion, ndërsa këta serverë bëjnë autorizimin e përdoruesve lokal. Njëkohësisht do të mundësohet printimi direkt në IP te printerit/fotokopjes ndërsa i tërë procesi duhet të monitorohet nga softueri menaxhues.

2. Institucioni – Infrastruktura B: Institucionet me printime mesatare (300,000 deri ne 600,000 printime ne muaj).

Një server është i instaluar lokalisht. Të gjithë urdhrat për printim do te jene te ruajtura lokalisht. Serveri lokal i instaluar në institucion i dërgon vetëm të dhënat statistikore te

printimit/kopjimit/skanimit/faksimit, ndërsa sa i përket autorizimeve ne pajisje, ato bëhen përmes serverit lokal apo edhe serverit kryesor Slave te vendosur ne QSHDH varësisht prej konfigurimit. Njëkohësisht do të mundësohet printimi direkt në IP te printerit/fotokopjes ndërsa i tërë procesi duhet të monitorohet nga softueri menaxhues.

3. Institucioni – Infrastruktura C: Institucionet me pak printime (deri ne 300,000 printime ne muaj).

Nuk ka te instaluar server lokal. Te gjithë urdhrat për printim dërgohen tek serveri kryesor Slave si dhe të gjitha autorizimet njëkohësisht menaxhohen prej këtij serveri. Asgjë nuk ka të ruajtur lokalisht te gjitha aktivitetet menaxhohen përmes serverit kryesor Slave te vendosur ne QSHDH. Njëkohësisht do të mundësohet printimi direkt në IP te printerit/fotokopjes ndërsa i tërë procesi duhet të monitorohet nga softueri menaxhues.


Procesi i printimit:

- Mënyra e printimit do te jete e centralizuar dhe çdo printim do te shkoj nëpërmjet softuerit i cili duhet te instalohet ne QSHDH ose AK-së qe ka infrastrukture të ndare dhe assesi nuk mund te ketë printime direkte nga kompjuteri ne pajisjet e printimit (USB apo ndonjë mënyre tjetër e printimit) ne infrastrukturen e institucioneve te cilat do te jene te përfshira ne projekt ne mënyre qe çdo printim te jete i kontrolluar, monitoruar dhe llogaritur kostoja e çdo printimit nga çdo person i përfshire ne kete projekt.
- Operatori ekonomik do te ofroje solucion qe mbështete edhe printimin direkt ne printer për institucionet te cilat kane kërkesa te tilla, ndërsa te gjitha aktivitetet e përdoruesit dhe pajisjes (printim/kopje/skanim) do të monitorohen nga softueri menaxhues. Kjo mundësi do të ofrohet për të gjitha institucionet ku kërkohet printimi direkt
- Vetëm pasi që shfrytëzuesit të autorizohen në pajisje nëpërmjet lexuesit te kartës, pajisja do te fillojë procesin e printimit te dokumentit te caktuar.
- Asnjë përmbajtje e dokumenteve te printuara/skanuara nuk do te ruhet ne hard disqe apo memorje te paisjeve për printim/skanim pasi qe ky veprim te kryhet nga pajisja.
- Çdo dokument qe duhet printuar do te jete i enkriptuar, enkriptimi do te filloj prej momentit kur jepet urdhri për printim nga kompjuteri deri ne momentin qe dokumenti është i printuar
- Asnjë informate mbi përmbajtjen e dokumenteve te printuara (përveç titullit dhe llojit te dokumentit – word, pdf, excel, etj) nuk mund të ruhet diku tjetër.
- Art House do te ofroje mundësinë e limitimit te numrin te printimeve (bardh e zi apo me ngjyra) për shfrytëzuesit e veçantë për te cilët AK do te mund te kërkojë limitimin e numrit te printimeve. Në momentin e tejkallimit të këtyre limiteve, softueri do të mundësoje refuzimin e printimeve për shfrytëzuesin.

Procesi i skanimit:

- Para se fillohet një aktivitet i skanimit secili shfrytëzues do të autentikohet me kartë në pajisjen adekuate për skanim (pajisje multifunksionale print/copy/scan)
- Përmes sistemit të autorizimit të përdoruesit në pajisje, softueri menaxhues do të ofrojë mundësinë e skanimit vetëm në e-mail adresën e personit të autorizuar, dhe në këtë mënyrë skanimet bëhen vetëm tek e-mail i personit të autorizuar në mënyrë që të mos mundësohet të dërgohen skanimet direkt nga pajisja e skanimit apo pajisja multifunksionale tek ndonjë adresë jashtë institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës duke e mbrojtur kështu sigurinë e informacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Informatat e skanimeve do të shkojnë nëpërmjet softuerit i cili do të jetë i instaluar në QSHDH ose AK-së që ka infrastrukture të ndara në mënyrë që çdo muaj të mund të raportohet për të gjitha aktivitetet e skanimeve të muajit paraprak nga të gjithë shfrytëzuesit e pajisjeve.
- Asnjë informate mbi përmbajtjen e dokumenteve të skanuara nuk do mund të ruhet diku tjetër, përveç lokacionit (shared folder) ku kërkohet nga autoriteti kontraktues ose dërgim direkt në e-mail.
- Art House do të ofrojë mundësinë e limitimit të numrit të skanimeve për shfrytëzuesit e veçante për të cilët AK do të mund të kërkojë limitimin e numrit të skanimeve. Në momentin e tejkalimit të këtyre limiteve, softueri duhet të mundësojë refuzimin e skanimeve për shfrytëzuesin.

Në diagramin më poshtë është i cekur procesi i skanimit të cilin e ofron Art House:



Procesi i fotokopjimit:

- Ashtu si edhe printimi dhe skenimi, as fotokopjimi nuk mund të kryhet pa u autorizuar me kartelë në pajisjen adekuate për fotokopjim (pajisje multifunksionale print/copy/scan)
- Informatat e fotokopjimeve do të shkojnë nëpërmjet softuerit i cili do të jetë i instaluar në QSHDH ose AK-së që ka infrastrukture të ndara në mënyrë që çdo muaj të mund të raportohet për të gjitha aktivitetet e fotokopjimeve të muajit paraprak nga të gjithë shfrytëzuesit e pajisjeve.
- Asnjë informate mbi përmbajtjen e dokumenteve të fotokopjuara nuk mund të ruhet diku tjetër (sqarime shtese kërkohet nga OE për këtë pjesë)
- Art House do të ofrojë mundësinë e limitimit të numrit të fotokopjimeve për shfrytëzuesit e veçantë për të cilët AK do të mund të kërkojë limitimin e numrit të fotokopjimeve. Në momentin e tejkalimit të këtyre limiteve, softueri do të mundësojë refuzimin e kopjimeve për shfrytëzuesin.

Redudanca

- Art House do te ofroje solucion softuerik i cili posedon redudance totale mbi ndonjë prishje eventuale te serverit baze ku është i instaluar softueri baze .
- Duke pasur një Redudance totale softueri nuk mund te ndalet asnjëherë së funksionuari duke e ditur që i gjithë procesi i printimit, skanimit dhe fotokopjimit duhet te shkoje nëpërmjet serverit kryesor, per kete arsye serveri kryesore do te jete Fileover Cluster.
- Komunikimi ne mes te këtyre serverëve do te jetë i enkriptuar.

Menaxhimi i pajisjeve:

- Softueri Menaxhues mundëson monitorimin e pajisjes për prishjet aktuale dhe te mundshme, te planifikuara.
- Softueri Menaxhues përmes një e-maili te krijuar për dërgimin e notifikimeve (e-mailave te dërguara nga pajisjet për intervenim) te cilat dërgohen lokalisht brenda institucioneve, përdorë këtë e-mail për te dërguar këto kërkesa për intervenim tek Art House për intervenimin aktual ne terren.
- Softueri Menaxhues ka mundësinë e raportimit të problemeve të pajisjeve brenda një kohe se caktuar (javore, mujore etj.) si dhe tposedon mundësinë e raportimit te përqindjes (%) se shfrytëzimit te pajisjes.

Raportimi:

- Softueri i ofruar posedon mundësinë e raportimit ne baze te aktiviteteve për secilin përdorues. Raportimet do te jene te detajuara dhe do te paraqesin: kohen, aktivitetin, totalin për kohe te caktuar te ndare për secilin aktivitet, etj.
- Softueri posedon mundësinë e raportimit në bazë të institucioneve, duke përfshirë edhe raportet për departamentet të përfshira në këto institucione.
- Softueri i propozuar posedonmundësinë e personalizimit të raporteve në baze të kërkesave të Institucioneve të Qeverise se Republikës së Kosovës.
- Softueri posedon mundësinë e përcaktimit të raporteve automatike të dërguara përmes e-mail tek personat e paracaktuar përgjegjës.
- Softueri do të ketë mundësinë e raportimit për statusin e pajisjeve (problemeve dhe kohen e shfrytëzimit te saj -UpTime) ne baza kohore.
- Softueri do te ketë mundësinë e krijimit te raporteve te ndryshme sipas kërkesave të Institucioneve të Qeverise së Republikës së Kosovës.
- Raportimi do te jete ne atë mënyre qe ne baza kohore (muaj, 3 mujore, etj.) do të dërgohet ne mënyre automatike tek personat përgjegjës për secilin institucion, i detajuar në numrin e printimeve/kopjimeve/skanimeve për secilin institucion përkatës dhe departamenteve te saj. Këto raporte duhet të gjenerohen dhe dërgohen në mënyre automatike në datat e caktuara.
- Faturimi do te behet nga OE i saktësuar sipas këtyre raporteve, për secilin institucion. Fatura do te përmbajë çmimin sipas kontratës me te gjitha taksat e Republikës se Kosovës te përfshira.

Singerisht u juaj

Blin Zeqiri

Art House, Dretor Menaxhues

26 Dhjetor 2017

